



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 1 prill 2019

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 21 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; në mbështetje të nenit Neni 25 pika 2.a, e Rregullores Nr. 02/2018 të Njësisë Ligjore, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese shpall:

KONKURS
të brendshëm për plotësimin e vendit të punës nëpërmjet procedurës së avancimit

1.

Pozita: Këshilltar i Lartë Kushtetues Juridik
Kodi: GJ-DL 02-09
Kohëzgjatja e kontratës: Pa afat

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës

Nën mbikëqyrje të këshilltarit të Parë kushtetues juridik dhe të gjyqtarëve përkatës, mbështet punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza dhe duke ndihmuar në hartimin e vendimeve, të raporteve dhe të materialeve të tjera juridike të hartuara nga Gjykata Kushtetuese.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Ndhmon ne përgatitjen e raporteve paraprake, të vendimeve dhe të materialeve të tjera ligjore që ndërlidhen me juridiksionin e Gjykatës;
- Bën analiza kushtetuese dhe ligjore;
- Merr pjesë në seanca shqyrtuese dhe mban shënime për rastet;
- Përgatit opinione kushtetuese-ligjore sipas kërkesave të Kryetares apo të gjyqtarëve të Gjykatës;
- Monitoron dhe udhëzon këshilltarët kushtetues juridikë lidhur me detyrat që u janë caktuar atyre në raste;
- Kontribuon në funksionimin efikas dhe efektiv të Njësisë Ligjore si dhe kryen detyra që kërkon këshilltari i Parë kushtetues juridik;
- Është përgjegjës për të siguruar kualitetin e vendimeve të Gjykatës në rastet në të cilat janë caktuar dhe është përgjegjës për të mbështetur hulumtimin, analizën dhe hartimin e vendimeve mospajtuese sipas këshillës së gjyqtarit.

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme

- Përgatitje e avancuar universitare në shkencat juridike, me ekspertizë në të drejtën publike, në të drejtën kushtetuese dhe të të drejtave të njeriut;
- Së paku 5 (pesë) vjet përvojë profesionale juridike;
- Të jetë person me integritet të lartë personal dhe moral.

Kandidati për pozitën e këshilltarit të lartë kushtetues juridik (senior) duhet të posedojë njohuri të thella profesionale, si dhe aftësi të shkëlqyeshme hulumtuese, analitike dhe organizative. Preferohet të ketë provimin e jurisprudencës si dhe përvojë në gjyqësi.

Po ashtu, kandidati duhet të demonstrojë qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve adekuate me burime të kufizuara, të ketë aftësi të zhvilluara komunikimi (në mënyrë verbale dhe me shkrim), të ketë aftësi për të identifikuar prioritetet, të ketë aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe ndjeshmëri me kolegë dhe palë; të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efikase nën presion kohor; të ketë aftësi për të trajtuar informatat e besueshme në mënyrë të duhur; të ketë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit, dhe hulumtimit në internet.

Kandidati duhet të njohë gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe të ketë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar.

Procedura e konkurrimit

I brendshëm (Avancim)

Procedura e konkurrimit është e hapur për gjithë anëtarët e Njesisë Ligjore të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit për avancim.

Rekrutimi dhe përzgjedhja do të bëhet në përputhje me Rregullores së punës Nr. 01/2018 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 të Njesisë Ligjore.

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: lulzim.syla@gjk-ks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese (DABNJ) në kopje fizike.

Konkursi i brendshëm mbetet i hapur 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës dhe në tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data 01/04/2019 deri më datën 05/04/2019, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 5 prill 2019, deri në ora 16.00.

Shënim:

Aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

#